



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 97-Korrik 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga punimet nëpër rrugët lokale në komunën e Malishevës



Përmbajtja:

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve.....	2
Kryetari Kilaj, priti palët	3
Fillon fushata e korrje-shirjeve në Malishevë	4
SHFMU “I.Mazreku”, përfituese e programit të USAID-it, për edukim bazik	5
U mbajt mbledhja e shtatëmbëdhjetë e radhës së KK të Malishevës	6
Komuna dhe FSK-ja, marrëveshje për ushtrimin “Luani i Shkathët 4”	6
Kryetari Kilaj inspekton disa nga punimet në Malishevë	7
Filloi ndërtimi i gjashtë rrugëve lokale.....	8
Zyra për Informim Publik në bashkëpunim me USAID-in, nxjerrin për publik fletëpalosjen “projektet 2011 dhe projekt buxheti 2012”	8
Kryetari Kilaj, shpreh ngushëllime për viktimat e tragjedisë së Norvegjisë.....	9

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve



Malishevë, 4 korrik

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve, e kryesuar nga kryetari Isni Kilaj, u trajtuan disa çështje, që kanë të bëjnë me punë dhe projekte komunale.

Kryetari Kilaj, tha të ketë veçuar disa çështje për këtë mbledhje, ndër të cilat:

- Projekti për oborrin e palestrës së sportit;
- Çështja pronësore rreth shtratit të lumit “Mirusha”, e cila është e paraparë me planë urbanistik;
- Raporti 6- mujor financiar;
- Kursimin e ujit dhe menaxhimin e mbeturinave, por edhe shlyerjen borxheve nga ana e konsumatorëve, ndaj kompanive të ujësjellësit dhe asaj të mbeturave;
- Respektimi i orarit të kujdestarisë në parkun “Sheshi i Dëshmorëve”, edhe gjatë vikendeve, ndërkohë që rregullimi i orarit të punëtorëve që punojnë vikendeve, të rregullohet që dy ditë të javës gjithsesi t’i kenë pushim;
- Përgatitja/ plotësimi i pyetësorëve për të riatdhesuarit, etj.

Në takimin e sotëm, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Sinan Kryeziu, ka bërë të ditur se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve, mirëpo Shtabi për këtë qëllim, do të formohet, pasi të jetë formuar në nivel shteti. “Për këtë vit do të korren 3600 hektarë me kulturë drithërash, janë në dispozicion 42 autokombajna, ndërkohë që fushata e korrje shirjes do të filloj, pas datës 10 korrik”, kështu bëri të ditur drejtori Kryeziu.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, njoftoj se janë bërë të gjitha përgatitjet sa i përket shpëtimit nga zjarri, për sezonin veror.

Kryetari Kilaj, priti palët

Malishevës, 7 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, si çdo të enjte edhe sot ka pritur palët, nga të cilët ka dëgjuar problemet e tyre, dhe ju ka ofruar asistencën e tij për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, si dhe ju ka dhënë udhëzimet apo këshillat e nevojshme, për çështjet e caktuara.

Numri i palëve, të cilët i ka pritur nga ora 9:30, deri në ora 12:00, ka qenë shumë i madh, ndërsa problemet e tyre kanë qenë kryesisht socio-ekonomike, pastaj shëndetësore, nevoja të ndryshme nga përditshmëria. Po ashtu, ka pritur edhe udhëheqës të fshatrave, të cilët kanë



para shtruar kërkesa, apo kanë biseduar për çështje të përgjithshme të fshatrave të caktuara, si uji, kanalizimi, rruga dhe të tjera.

Kryetari Kilaj, të gjithë ju ka dhënë përgjigjet e nevojshme, këshillat për çështjet e caktuara, si dhe orientimet e nevojshme. Po ashtu edhe për çështjet e përgjithshme të komuniteteve të caktuara, kryetari Kilaj, ju ka ofruar mbështetjen e komunës, për zgjidhjen e problemeve, si rrugë, kanalizime e ujësjellës.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Fillon fushata e korrje-shirjeve në Malishevë

Malishevë, 11 korrik



Gjatë kësaj fundjave, në Malishevë, filluar fushata e korrje-shirjeve, ndërsa shtabi komunal është duke përcjellë këtë fushatë. “Rendimentet e grurit janë të mira”, ka deklaruar drejtori për bujqësi, z. Sinan Kryeziu, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, përderisa ka njoftuar se “42 autokombajna që disponon Malisheva, janë të angazhuara në këtë fushatë për korrjen e grurit”.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, janë diskutuar disa çështje, si ajo e dërgimit të projekteve kapitale në ministritë përkatëse, pastaj pjesëmarrja e obligueshme e drejtorëve, në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komonale, pasi mes tjerash do të diskutohet edhe raporti i auditorit të përgjithshëm, ku asamblistët, mund të kenë pyetje për drejtorët.

Në këtë mbledhje, drejtori i arsimit, z. Isuf Morina, ka prezantuar konfirmimin e USAID-it, për renovimin e shkollës në fshatin Gurbardh, si dhe për procesin e regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta.

Ndërsa drejtori për shërbime publike, z. Alban Kastrati, ka bërë të ditur, se kanë filluar të vijnë kërkesa për furnizim me ujë për pije, nga disa qytetar. Për këtë qëllim kryetari Kilaj, urdhëroi që “sipas mundësive, të ndihmohen të gjitha rastet që paraqesin kërkesë për furnizimin me ujë”.

SHFMU “I.Mazreku”, përfituese e programit të USAID-it, për edukim bazik

Malishevë, 12 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, drejtori i DKA-së, z. Isuf Morina dhe në emër të SHMU “I. Mazreku”, z. Shaban Paçarizi, kanë nënshkruar sot një marrëveshje mirëkuptimi me Dr. Keith Prenton, udhëheqës i programit të USAID-it, për edukimin bazik, me anë të së cilës, do të formohet Qendra e Trajnimit Profesional për mësimdhënësit, me qëllim të rritjes së mësim nxënies, ndërsa ky është plan trevjeçar për trajnimin e mësimdhënësve.



“Jo vetëm që e mbështes këtë program, por jam i kënaqur që kemi fituar mbështetjen tuaj, pasi ne si Malishevë, kemi një popullatë të re dhe kemi nevojë për këto lloj trajnime dhe rritje të profesionalizmit në shkollë”, tha kryetari Kilaj, i cili i njoftoi përfaqësuesit e USAID-it, se Malisheva ka investuar shumë në arsim dhe ndërtim të shkollave.

Në anën tjetër, udhëheqësi i këtij programi të USAID-it, Dr. Keith Prenton, tha se “ky program është në shërbim të nxënësve, mësimdhënësve dhe shkollës”. Ai po ashtu, njoftoi se do të formohet e ashtuquajtura “klasa e shekullit XXI”, e cila do të pajiset me të gjitha mjetet moderne për mësim.

Gjatë këtij takimi, me kryetarit Kilaj dhe përfaqësuesit të USAID-it, u bisedua edhe për idenë, e shqyrtimit të mundësisë, për largimin e mbeturinave të plastikës, duke bërë grumbullimin, përmes shkollave (nxënësve), dhe më pas riciklimin e tyre, ide e cila u përkrah nga kryetari Kilaj, duke shprehur gatishmërinë për mbështetje nga ana e komunës. Një program i tillë, është testuar dhe ka dhënë rezultate në një shkollë në Kosovë.

U mbajt mbledhja e shtatëmbëdhjetë e radhës së KK të Malishevës

Malishevë, 13 korrik



Në mbledhjen e shtatëmbëdhjetë të Asamblesë Komunale, këshilltarët komunal kanë shqyrtuar raportin e auditorit të përgjithshëm, për punën e komunës së Malishevës, për vitin 2010, pastaj janë njoftuar lidhur me procesin e shpronësimit të pronave rreth lumit Mirusha, si dhe kanë marrë dy vendime tjera.

Në këtë mbledhje, ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ku është dashur të debatohet rreth raportit të punës për gjyshatë mujorin e parë të këtij viti, por me kërkesën e opozitës(LDK) dhe pëlqimin e kryetarit, e më pas edhe të shumicës së këshilltarëve komunal, ky debat u shty për mbledhjen tjetër.

Po ashtu, edhe çështja e shqyrtimit për shlyerjen e obligimeve të subjekteve afariste jo aktive, u shty për një mbledhje tjetër, pasi këshilltarët kishin dyshime për numrin e këtyre subjekteve jo aktive dhe mundësisë së ikjes nga obligimet që kanë ndaj komunës. Me kërkesën e kryetarit, u mor vendim që të formohet një komision nga ana e kuvendit, për verifikim e asaj liste për subjekteve jo aktive, të cilat i detyrohen komunës.

Kuvendi, po ashtu mori vendim edhe për ndërrimin e pronës private me atë publike, pas kërkesës së një banori nga Kijeva, për shkak se prona e tij pengon shkollën e mesme, si dhe kishte pëlqimin e fshatit Kijevë për ndërrimin e saja prone.

Komuna dhe FSK-ja, marrëveshje për ushtrimin “Luani i Shkathët 4”

Malishevë, 14 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe drejtori i Departamentit Civil-Ushtarak, në Ministrinë e FSK-së, z. Hajrush Kurtaj, kanë nënshkruaj një marrëveshje, me anë të së cilës, komuna e Malishevës, pajtohet që ushtrimi fushorë “Luani i Shkathët 4” i Forcës së Sigurisë së Kosovës, mund të realizohet në territorin e Komunës së Malishevës.



Gjatë takimit, kryetari Kilaj, i uroj FSK-në, “jo vetëm për këtë ushtrim fushor, por në përgjithësi, për suksese tjera, në drejtim të forcimit dhe rritjes së kapaciteteve të FSK-së”.

Në anën tjetër, z. Kurtaj, tha se “FSK është në fazën e kompletimit të dhe rritjes së kapaciteteve të saj”, ndërsa për marrëveshjen e sotme, ai tha se “gjatë ushtrimeve, në rast të dëmtimit eventual të pronave private, ato do të kompensohen.

Kryetari Kilaj inspekton disa nga punimet në Malishevë

Malishevë, 15 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, me qëllim të njohjes me ecurinë e punimeve në disa nga projektet që janë duke u realizuar aktualisht, sot i ka vizituar ato punime, duke u njohur drejtpërdrejt me ecurinë tyre dhe kualitetin e punës që është duke u bërë, si dhe ka vizituar QKMF-në, ku është njohur me shërbimet në këtë qendër mjekësore.



Fillimisht, janë shikuar punimet në njërin prej ndërtimeve më të rëndësishme në infrastrukturën sportive, stadiumin e futbollit, që është duke u ndërtuar në pjesën e kompleksit të sportit në Malishevë, ku ka parë ecurinë e punimit të kësaj fushe futbollit.



Më pas kryetari Kilaj, ka vizituar QKMF “Shpëtim Robaj” në Malishevë, ku ka inspektuar renovimet që janë duke u kryer në këtë qendër, si dhe është njohur drejtpërdrejt nga pacientët, me tretmanin që kanë nga ana e shërbimit mjekësor.

Më pas është vizituar edhe shkolla në fshatin Marali, ku është duke u ndërtuar aneksi i kësaj shkolle, si dhe punimet që janë duke vazhduar në ndërtimin e ndërtesës së Gjykatës Komunale në Malishevë.

Filloi ndërtimi i gjashtë rrugëve lokale

Malishevë, 19 korrik

Ka filluar rregullimi dhe ndërtimi i gjashtë rrugëve në komunën e Malishevës, të cilat priten të përfundojnë shumë shpejt. Përmes këtyre rrugëve do të lidhen lagjet me asfaltet kryesore. Një rrugë tjetër që do të asfaltohet është edhe ajo që shpie te Palestra e Sporteve në Malishevë.

Me realizimin e këtyre investimeve synohet përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore, si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës dhe mirëqenies së qytetarëve të komunës së Malishevës.

“Rrugët të cilat do të shtrohen, janë: rruga përballë stacionit, me gjatësi prej 120 metra; rruga në lagjen e Dukojve në Pagarushë, e gjatë 560 metra, pastaj ajo e Lacajve në Pagarushë 1110 metra, lagja Mekaj, e gjatë 330 metra, lagja e Gurit, e gjatë një kilometër dhe një kilometër tjetër për në Palestrën e Sporteve në Malishevë”, kështu ka bërë të ditur shefi i prokurimit, z. Elmi Paçarizi.

Të gjitha rrugët së bashku kapin një gjatësi prej 4120 metra (katër kilometra e njëqindnjëzet metra), ndërsa shuma e përgjithshme e investimit, është 220 594.50 euro.

Zyra për Informim Publik në bashkëpunim me USAID-in, nxjerrin për publik fletëpalosjen “projektet 2011 dhe projekt buxheti 2012”

Malishevë, 28 korrik



Zyra për Informim Publik dhe Agjencioni i Sheteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Programi për Komuna Demokratike dhe Efektive në Kosovë, kanë përgatitur për qytetarët e komunës së Malishevës, fletëpalosjen në lidhje me projektet 2011 dhe projekt buxhetin 2012.

Përmes kësaj fletëpalosje, janë pasqyruar disa nga të dhënat që kanë të bëjnë kryesisht me investimet kapitale të gjashtë muajve të parë të vitit 2011, lista e projekteve kapitale për vitin 2012, si dhe objektivat e komunës së Malishevës.

Ky projekt, ka për qëllim ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjime publike, në mesin e të cilave edhe në ato për buxhet e financa.

(fletëpalosjen, mund ta gjeni në ueb-faqen zyrtare: <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>, në linkun <http://kk.rks-gov.net/malisheve/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>).

Në Ambasadën e Norvegjisë në Prishtinë

Kryetari Kilaj, shpreh ngushëllime për viktimat e tragjedisë së Norvegjisë

Malishevë, 28 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka vizituar Ambasadën e Norvegjisë në Prishtinë, për të shprehur ngushëllime dhe për të ndarë dhimbjen me shtetin norvegjez, pas tragjedisë që ndodhi të premten në këtë shtet, ku humben jetën mbi 90 qytetarë.

“Shprehë keqardhje dhe solidarizohemi me dhimbjen tuaj, ndërsa në shenjë respekti për viktimat e tragjedisë në Norvegji, shprehë ngushëllimet e sinqerta”, kështu është shprehur midis tjerash kryetari Kilaj gjatë vizitës në Ambasadën e Norvegjisë.

Z. Kilaj tha gjithashtu se populli i Kosovës, e në veçanti ai i Malishevës, i janë mirënjohës shtetit të Norvegjisë për kontributin e dhënë, ndërkohë që ndajmë dhimbjen me këtë shtet.